

Prizreni dhe Unesco-Alternivat e Përfshirjës

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit



RAPORT I SHKURTER MBI ZHVILLIMET E KONFERENCES

Prizreni dhe Unesco-Alternivat e Përfshirjes

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

**Përgatitur nga: Skender BOSHTRAKAJ
Bariu ZENELAJ**

Prizren, Maj 2013

Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjës

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

Parathënie

Në organizim të Komunës së Prizrenit, dhe nën përkujdesjen e Nën Kryetarit të Komunës, më 16 dhe 17 Maj 2013, është mbajtur konferenca me temën " Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjës'".

Ky raport përmban një përmbledhje të prezantimeve dhe kontributeve të folësve/ekspertëve nga Kosova dhe regjioni, të cilët kanë një përvojë ndërkombëtare, në proceset e anëtarësimit të vendeve të tyre në UNESCO. Konkluzionet dhe rekomandimet të dalta nga kjo konferencë, do të shërbejnë për qëllime të përfshirjës së Prizrenit në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Duke krijuar një forum të gjërë për të diskutuar gjendjen aktuale, kapacitetet, idetë, dhe pyetje tjera lidhur me përfshirjen e Prizrenit në Listën e Trashëgimisë Botërore nën mbrojtje të UNESCO-s, pjesëmarrësit në konferencë kanë reflektuar për vlerat e Prizrenit, mundësitë dhe pengesat në këtë proces duke e krahasuar (barasvlerësuar) Prizrenin me dy studime të rasteve, Berat dhe Gjirokastrë¹. Në konferencë kanë marrë pjesë Kryetari i Komunës së Prizrenit dhe përfaqësues nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Urbanizmit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Drejtoresha e Departamentit të Trashëgimisë dhe përfaqësues tjerë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoresha e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, përfaqësues të Instituteve Profesionale të Trashëgimisë, përfaqësues nga Berati dhe Gjirokastra, ekspert në fushën e trashëgimisë kulturore nga Kosova dhe Shqipëria, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të cilët punojnë në fushën e trashëgimisë kulturore (ATTA, LEGATUM, EUIRC dhe RrOK), përfaqësues nga Abasada

¹Berati dhe Gjirokastra janë të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si njësit i vetëm. Ato kanë të njëjtat Vlera të Jashtëzakonshme Universale dhe si të tilla janë konsideruar si një. Gjirokastra ia propozoi zyrtarisht autoriteteve të UNESCO 's për t'u përfshirë në Listën e Siteve për Trashëgimi Botërore - Dosja u dorëzua zyrtarisht me 22 janar 2002. Në mbledhjen e mbajtur në Dubai në korrik 2005 të Sesionit të Komitetit për Trashëgimi Botërore, Gjirokastra u përfshi në listën e Siteve Trashëgimi Botërore. Është shpallur sipas kriterit (iii): "që përbën një dëshmi unike të një tradite kulturore të jetës, të zhvilluar në shek. 14-19". Sipas kriterit (iv) : tipi i shtëpisë së fortifikuar të Gjirokastrës paraqitet si shembull i dallueshëm i një tipi konstruksioni që ilustron një mënyrë jetese në periudhën shek. 14-19" . Gjirokastra është regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 2005, e Berati i është bashkuar në këtë listë në vitin 2008, gjatë Sesionit të Kebekut të Komitetit të Trashëgimisë Botërore.

Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjes

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

Amerikane në Kosovë, Organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufij (ChEB) dhe donatorët, për të diskutuar çështjen e përfshirjes së qytetit të Prizrenit në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Një vlerë e shtuar konferencës ishte kontributi i Profesor Dr. Emin Riza, si bartës i procesit të hartimit të dosjeve për aplikimin e qytetit të Beratit dhe Gjirokastrës në UNESCO, përfaqësuesit e qyteteve Berat dhe Gjirokastrë dhe në veçanti kontributi i zonjës Marelë Guga, përfaqësuese e Bashkisë së Beratit, prezantimi i nismave të ztr.Pavlo Shkarpa me Organizatën “Antipatrea” dhe grupi i arqitektëve të rinjë, të cilët kishin bërë një analizë krahasuese të qyteteve Berat-Gjirokastrë-Prizren. Nga fillimi i konferencës, prezantimet, komentet dhe kontributet profesionale dhe qytetare, kanë provuar se ka një besim të plotë dhe një marrëveshje të gjërë të të gjithë pjesëmarrësve, që ky proces është realisht i mundur, i nevojshëm dhe si i tillë duhet të konkretizohet me një varg masash në të gjitha nivelet.

Procesi i përfshirjes së Prizrenit në Listën Botërore të Trashëgimisë, nuk është një tentativë e re dhe nuk fillon vetëm tani. Në të kaluarën e afërt në kohën e ish-Jugosllavisë, me kërkesën e institucioneve të atëherëshme për ta përfshirë Prizrenin në Listën Botërore të trashëgimisë (kërkesa e bërë më 1972), Prizrenit i është bërë një vlerësim nga ana e UNESCO's (të lutem gjejini të bashkangjitur raportin e vlerësimit të UNESCO's të vitit 1975).

Raporti nxjerrë në pahë shumë mangësi dhe të gjetura të cilat duhen të ktheheshin në detyra të shtëpisë për institucionet e atëherëshme vendore, në mënyrë që të mund të bëhet përafrimi me procedurat e aplikimit të Prizrenit për përfshirje në Listën Botërore të Trashëgimisë. Prandaj kjo mund të jetë një bazë e mirë për ta inicuarë procesin e aplikimit të Prizrenit për Listën Botërore të Trashëgimisë, edhe pa qenë Kosova shtet anëtarë i Kombeve të Bashkuara, sikurse që e kërkojnë kriteret dhe procedurat e aplikimit.

Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjës

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

Zhvillimi i Diskursit

Pjesëmarrësit folën në mënyrë elokumente për vlerat e Prizrenit duke zgjeruar diskutimin në gjetjen e mënyrave më të mira për ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e këtyre vlerave. Një mundësi e mirë dhe realiste është edhe nisja e përgatitjeve për aplikim të qytetit të Prizrenit për të hyrë në Litën e Trashëgimisë botërore. Ishte e qartë për të gjithë pjesëmarrësit që ky status është i mbushur me obligime vendore, po aq sa është një njohje prestigjioze ndërkombëtare. Në konferencë u potencua disa herë dhe nuk kishte dilema që UNESCO nuk është një institucion financiar dhe pritjet duket të ishin realiste në kuptimin e përfitimeve të qytetit nga ky nominim. Në mënyrë të qartë dhe të komunikueshme në konferencë u paraqiten qendrimet e zyrtarëve, ekspertëve dhe qytetarëve për qytetin e Prizrenit, vlerat, sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të qytetit si tërësi.

Nga fillimi, dolën në pah përkufizimet e dy koncepteve të ndryshme për qytetin. Diskursi zyrtar-ligjor që njih **“Qendrën Historike të Prizrenit”** dhe diskursi i ri që e përcepton Prizrenin si tërësi vlerash të ruajtura nga e kaluara dhe si qytet aktiv kulturor në ditët e sotme. **“Prizreni-Qytet Historik”** ishte përkufizimi më i përdorur nga të gjithë folësit dhe pjesëmarrësit në konferencë. Nocioni **“Qendra Historike e Prizrenit”** në diskursin e folësve pa përjashtim ishte një koncept (pak i përdorur), me sa duket i pa mjaftueshëm për trajtimin e temës dhe nocioni i zgjeruar i përceptimit të qytetit si tërësi kulturore-historike e përshkoi pothuajse gjithë konferencën. Duke filluar nga fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës, Profesor Dr. Ramadan Muja, ku ai paraqiti një histori të shkurtër të qytetit dhe një përshkrim të funksioneve politike, ekonomike, kulturore të qytetit të Prizrenit përgjatë periudhave të ndryshme historike, dhe në të njëjtën frymë të gjithë pjesëmarrësitë i argumentonin vlerat e Prizrenit si tërësi kulturore-historike.

Përkufizimet e këtyre dy koncepteve nuk ishin temë dhe prioritet në vete në konferencë megjithatë, në diskursin e debatit është vërejtë që Prizreni përjetohet si një tërësi kulturore-historike duke përfshirë edhe mënyrën e jetës në ditët moderne, dhe jo vetëm si qytet ku janë të ruajtura disa objekte me vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Të dyja

Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjës

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

strukturat e programit (pjesa e prezantimeve formale dhe diskutimet jo-formale) konfirmuan, që pjesëmarrësit në një diskutim të hapur dhe me qasje ndër-disiplinore, zhvillimin e Prizrenit e përjetojnë si një tërsi të integruar urbane.

Analiza me kujdes e këtij diskursi nxjerrë në pah nevojën për një debat më të zgjeruar për këtë temë dhe së dyti, sinjalizon institucionet e shtetit që të trajtojnë qytetin e Prizrenit si tërsi urbane-kulturore-historike-ekonomike, të rishikojnë statusin e Qytetit të Prizrenit dhe të ndjekin një politikë të konzervimit të integruar për qytetin si tërsi.

Konkluzionet dhe Rekomandimet

Konferenca ka nxjerrë në pah se ekziston një koncensus parimor mes Autoriteteve të qeverisë lokale, Ministrisë së Kulturës, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Shoqërisë Civile, Instituteve Profesionale të Trashëgimisë, Ekspertëve të fushës së Trashëgimisë Kulturore, për pjesëmarrje dhe kontribut në këtë proces.

Në vijim janë Konkluzionet dhe rekomandimet, të përmbledhura nga seanca e fundit e ditës së dytë të Konferencës:

- ***Përpyjekjen e Komunës së Prizrenit duhet zgjeruar*** me veprime të koordinuara ndër-institucionale, duke rritur bashkëpunimin, me ekspertët e fushës, akademikët, politikëbërësit, pronarët e aseteve kulturore dhe bizneset, me mediat dhe shoqërinë civile.
- ***Mbështetja e plotë e Institucioneve qëndrore të shtetit*** të Kosovës për qytetin e Prizrenit është parakusht për marrjen e statusit nën mbrojtje të UNESCO-s. Së pari sepse Shteti është autoriteti aplikues, së dyti sepse shteti duhet të tregojë nivelin e përkushtimit, mënyrën e trajtimit, mekanizmat e menagjimit, të alokon fonde shtesë për mbrojtje dhe restaurim, etj.

Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjës

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

- Procesi i përgatitjës së Dosjës mund të fillon menjëherë, 1) duke formuar një **Grup Pune** (shumë i ngushtë) i cili do të harton 2) **Planin e Veprimt** ku do të përcaktohen qartë hapat dhe procedurat, detyrat që duhen kryer, institucionet dhe personat përgjegjës, afatet kohore dhe masat tjera të nevojshme për përgatitjen e 3) **Dosjës për aplikim**.
- Të hulumtohet **dokumentacioni i viteve të 70-ta** kur për herë të parë autoritetet e e Ish-Jugosllavisë kanë inicuar procedurën e aplikimit për qytetin e Prizrenit në UNESCO. Njëkohësisht të kompletohet dokumentacioni dhe komunikimet e bëra nga institucionet e Kosovës me UNESCO-n nga viti 2000 e këndej.
- Një ndër hapat e parë që Komuna e Prizrenit duhet ta ndërmarr, pa marrë para syshë proceset tjera, është nisja e një **procesi të inventarizimit** (rexhistrimit) të të gjitha aseteve kulturore të Prizrenit. Inventari do të duhej të konstatonte vlerat e pretenduara edhe gjendjen e këtyre aseteve.
- Është i domosdoshëm hartimi i një **Analize të ligjeve**, planeve dhe strategjive ekzistuese që ndikojnë në ruajtën dhe konzervimin e integruar të qytetit të Prizrenit. Me fokus të veçantë në çështjet e **harmonizimit** përkundrejt **kolizionit** të këtyre normave dhe **vlerësimi i ndikimit të tyre** në mbrojtjen, ruajtjen dhe menagjimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit.
- Nga perspektiva sektoriale në konferencë u bë e dukshme që ka një mori dokumentesh që e ndihmojnë këtë proces. Baza ligjore konsiderohet e kompletuar dhe në kuptimin e brendshëm Kosova/Prizreni, nuk ka asnjë pengesë ligjore për të kryer hapat e nevojshëm deri në aplikim për UNESCO. Megjithatë kur bie fjala për dokumentet specifike dhe nocionet e përdorura gjatë konferencës si: Planet rregullative, Plani i Menagjimit, Hartimi i Planit të Menagjimit, Master Plani, Plani i Konzervimit, Politika e mbrojtjes, Shpallja nën mbrojtje të shtetit; është vërejtur një qasje e fragmentuar sektoriale në interpretim të këtyre dokumenteve. Për të kuptuar më mirë hierarkinë e këtyre dokumenteve paraqitet nevoja që këto nocione dhe koncepte tjera të fushës, të analizohen dhe të standardizohet përdorimi i këtyre nocioneve. Njëra prej zgjidhjeve

Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjës

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

mund të jetë hartimi i një **Udhëzuesi-doracaku** që ofron informata dhe instruksione për zbatimin e tyre të kordinuar të subordinuar dhe të bashkërenduar.

- Duke pasur parasysh zhvillimet e hovshme dhe të pa kontrollueshme në fushën e ndërtimeve gjatë dekadës së kaluar , e deri në ditët e sotme dhe debatet rreth interpretimit të dokumenteve të planifikimit urban në nivel të qytetit dhe në nivel të vendit, konsiderohet si e nevojshme ndërmarrja e masave urgjente për vënien nën kontrollë të rregullimit të territorit. **Kufizimi i ndërtimeve të reja** deri sa të hartohen **Planet e konzervimit**.
- Nga biseda që u zhvillua, u identifikuan edhe një sërë çështjesh të tjera që mund të zgjidhen nga Komuna paralelisht me përgatitjen e Dosjës për aplikim në UNESCO. Ato kanë të bëjnë me **rregullimin e infrastrukturës** rrugore, sinjalizimit, rregullimit të trotoareve dhe të shtigjeve për këmbësor, të rrjetit të energjisë elektrike (largimi i telave), shenjëzimet e standardizuara, administrimi i reklamave dhe mbishkrimeve në qytet, menagjimi i mbeturinave, rregullimi i fasadave, identifikimi, mbrojtja dhe (re)krijimi i pejsazheve urbane e natyrore, etj.
- **Aktivitetet e promovimit** të qytetit të Prizrenit dihet të intensifikohen.
- Duhet të fillohet me një **program intenziv i trajnimeve** dhe masave tjera për ngritje të kapaciteteve për planifikim, menagjim, restaurim, promovim.
- **Rritja e bashkëpunimit me qytetin e Beratit dhe Gjirokastrës**, për të mësuar nga përvojat e këtyre qyteteve, që nga përgaditja e dosjeve deri te menagjimi aktual dhe sfidat e performancës brenda kritereve të UNESCO-s.
- Vendosja e një **komunikimi bashkpunues (përpos Beratit e Gjirokastrës) edhe me qytete tjera të rajonit** dhe më gjërë, që janë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Duke marrë në konsideratë edhe nismën e z. Ruzhdi Rexha, Nën Kryetar i Komunës së Prizrenit, për organizimin e Konferencës Rajonale të Qyteteve në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Prizreni dhe Unesco-Alternativat e Përfshirjës

16 dhe 17 Maj, 2013

Shtëpia e Bardhë e Komunës së Prizrenit

Folësit/Prezantuesit :

Prof.Dr.Ramadan MUJA (Kryetari i Komunës së Prizrenit)

Ztr.Ruzhdi REXHA (Nën-Kryetari i Komunës së Prizrenit)

Ztr.Paul ENGELSTAD (Ambasada Amerikane në Kosovë)

Prof.Dr.Emin RIZA (Shqipëri)

Znj.Xhejlane HOXHA (Këshilli Kosovës për Trashëgimi Kulturore)

Pavlo SHKARPA (Shqipëri/Berat)

Znj.Marela Guga (Shqipëri/Berat)

Përmbledhur nga:

Skender Boshtrakaj, Moderator i Konferencës

Bariu Zenelaj, (ATTA)

This document was created with Win2PDF available at <http://www.daneprairie.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.